

# LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 6: Tetor 2020



## Të dashur prindër,

viti shkollor 2020-2021 ka filluar dhe jemi mirënjohës që çdo gjë po shkon mirë. Kohëzgjatja e orëve të mësimi është ruajtur. Po ofrohet shërbimi i transportit dhe i mensës dhe jemi shumë të kënaqur që deri tani nuk kemi nxënës apo mësues të infektuar.

Sigurisht që sfida ka dhe do të ketë, por me mbështetjen tuaj kemi besim që do t'ia dalim mbanë. Për shkak të gjendjes jo të zakonshme të shkaktuar nga pandemia e COVID-19, ky vit shkollor do të jetë ndryshe nga vitet e tjera përse i përket mënyrës së organizimit. Ne ju kemi dërguar vazhdimisht informacione me anë të mësuesve kujdestarë në lidhje me fillimin e vitit shkollor:

Letër informuese

orarin, rregullat e sjelljes dhe masat ndaj COVID-19, grafikët, regjimin dhe orarin e autobusave.

Synimi ynë, edhe këtë vit, është të ofrojmë një arsim cilësor për nxënësit duke i aftësuar ata të fitojnë kompetenca dhe të formojnë personalitetin e tyre përmes zbulimit të botës, si dhe potencialeve të tyre. Ne do të ofrojmë mundësi për ta që të provojnë situata të ndryshme të të nxënës dhe të vetë jetës, me qëllim që ata të marrin përgjegjësi për jetën, familjet e tyre dhe shoqërinë, në të cilën ata jetojnë dhe duke inkurajuar lirinë dhe barazinë midis njerëzve.

Ju, prindër, jeni partnerët tanë në edukimin e fëmijëve dhe ne kërkojmë edhe më tej mirëkuptimin

dhe mbështetjen tuaj në mënyrë që të mund të arrijmë me sukses synimin dhe objektivat tona të përbashkëta. Le të vazhdojmë të mbështesim njëri-tjetrin për të bërë më të mirën për të ardhmen e fëmijëve tanë. Ju ftojme të lexoni më tej dhe për çdo mendim dhe sugjerim jeni mëse të mirëpritur të na kontaktoni.

Me respekt,

**Elona Rira**

Drejtoreshë e Shkollës NEHEMIA  
elona.rira@ng.team

**Donika Nasto**

Drejtoreshë e Programit të Zhvillimit të Shkollës  
donika.nasto@ng.team

## Zhvillimi i mëtejshëm i shkollës dhe menaxhimi i cilësisë.

Në vitin 2018, Shkolla NEHEMIA inicioi programin e zhvillimit të shkollës, duke patur në fokus gjithëpërfshirjen dhe individualizimin.

Mbyllja e vitit shkollor 2019-2020 u krye në situata të paparashikuara dhe ndryshe nga ç'ishte planifikuar. Megjithatë, ne analizuam objektivat e vendosura në fillim të vitit dhe nxorëm përfundimet tona të arritjeve dhe të nevojave për përmirësime.

Në bazë të kësaj analize, rreth 80% e mësuesve të Shkollës NEHEMIA, përdorin metoda interaktive të mësimdhënies (kombinim të tyre); përdorimi i mjeteve teknologjike në mësimdhënie është në rritje dhe nota mesatare si shkollë është rritur me 0.5 (nga testimi i jashtëm).

## Viti shkollor 2020-2021

Pavarësisht kushteve dhe vështirësive, jemi shumë të gëzuar që mund t'i kemi përsëri pranë nxënësit, po ashtu edhe ata janë shumë të lumtur që mund t'i kthehen përsëri normalitetit, për aq sa është e mundur të flasim për normalitet.

Për nxënësit e klasës së VI-të dhe të XI-të, në njëfarë mënyre, viti shkollor filloi që në fund të muajit gusht. Shkolla NEHEMIA ofroi për ta nga data 24 gusht deri më 4 shtator një mësim përsëritës të lëndëve të vitit të kaluar, por edhe u ofroi një mundësi për të njohur mësuesit dhe njëri-tjetrin, për ata që ishin për herë të parë në Shkollën NEHEMIA.



## Kopshti

Eksperienat pozitive të sistemit parashkollor u mundësojnë fëmijëve fillimin më të mirë të jetës.

Programi ynë i sistemit parashkollor fokusohet në mbështetjen e fëmijëve për të arritur potencialin maksimal duke zhvilluar aftësitë shoqërore, vetëdijen dhe respektin, aftësitë emocionale, gjuhësore, letrare, aftësitë numerike dhe punën në grup nëpërmjet lojës dhe punës.

Krahas aktiviteteve të përditshme në kampus, kopshti ka kryer edhe vizita tek shërbimi i zjarrrfikësës së qytetit, ku kanë mësuar dhe janë argëtuar njëkohësisht.



Janë bërë trajnime të vazhdueshme me trajnues brenda dhe jashtë vendit dhe cilësia është gjithmonë e në rritje. Në bazë të analizës së vitit të kaluar dhe të ndryshimeve të stimuluar nga pandemia, për këtë vit shkollor fokusi do të jetë: Integrimi i të Mësuarit të Kombinuar (Blended Learning); Forcimi i përdorimit të metodave mësimore interaktive (duke synuar gjithëpërfshirjen dhe individualizimin) si edhe forcimi i projekteve sociale dhe binjakëzimi i shkollave.

Për këtë qëllim janë realizuar edhe trajnime të personelit mësimdhënës rreth programeve kryesore kompjuterike, si edhe mbi përdorimin e programeve digjitale për mësimdhënien. Trajnime të tjera për vitin e ardhshëm shkollor janë në planifikim.

Në të ardhmen, për vlerësimin periodik dhe të rregullt të cilësisë së mësimdhënies në shkollë, të performancës, efektivitetit dhe eficiencës së mësimdhënies do të jetë Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në shkollë.

## Lajmërimet e ndryshme

Në faqen e internetit të Shkollës NEHEMIA <https://www.nehemiah-gateway.al/al/nehemiah-school> do të gjeni njoftime, informacione rreth shkollës si dhe njoftime të rëndësishme. Ju këshillojmë ta vizitoni herë pas here për të qenë gjatë gjithë kohës të informuar.

Për Shkollën NEHEMIA, ky vit shkollor ka kërkuar një investim të madh në pajisje (mbi 9,500 euro), duke filluar që nga kompjuterat për stafin mësimor, webkamera profesionale dhe deri tek platforma "SchoolMe".



## Bursa e Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari

Për të dytin vit radhazi, edhe këtë vit u zhvillua konkursi: "Bursa e Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari". (<http://lyhnidafund.com/>)

Kjo iniciativë është themeluar në vitin 2018 nga Lazon Gusho dhe Lori Çobani, alumni të Shkollës NEHEMIA, në nder të emrit dhe veprës së gjyshit të tyre, Dr. Jorgji Jajçarit. Qëllimi i kësaj burse është t'i mundësojë një nxënësi financiarisht ndjekjen e Shkollës NEHEMIA për një vit. Fituesi i këtij viti është Egli Xhemollari, në klasën e X-të.



## I UROJMË MIRËSEARDHJEN:



### Erald Zeqollari

Eraldi është diplomuar në Tiranë për mësimdhënie të gjuhës angleze. Në vitin 2015 është certifikuar me TESOL dhe në vitin 2019 është certifikuar nga Ontario Secondary School Diploma dhe ka marrë lejen e mësimdhënies për

kurrikulën e Ontarios, Kanada.

Që nga viti 2012 deri në 2020 ka punuar në shkollë të ndryshme ndërkombëtare në Kinë. Ka eksperiencë të gjerë në mësimdhënien e TOEFL, IELTS dhe Cultural English. Eraldi është i punësuar me kohë të plotë tek Shkolla NEHEMIA dhe zhvillon lëndën e gjuhës angleze për klasat III, V, VIA, VII, VIII dhe XII.



### Era Latollari

Era ka mbaruar studimet për mësuese të edukimit fizik, sporte dhe shëndet. Ka punuar në shkollën "Viktor Hygo" në Tiranë dhe është shumë e apasionuar ndaj profesionit të saj.

Era është e punësuar me kohë të plotë tek Shkolla NEHEMIA dhe zhvillon lëndën e edukimit fizik në klasat VI – XII.



### Shpresa Nikolla

Mësuese matematike me një përvojë të gjatë pune.

Ka mbaruar studimet e larta në këtë degë dhe është drejtuese e shumë projekteve dhe olimpiadave rajonale dhe ndërkombëtare dhe e konkurseve, si edhe organizatore e shkollës

verore të matematikës.

Shpresa është e punësuar me kohë të pjesshme tek Shkolla NEHEMIA dhe zhvillon lëndën e matematikës në klasat VIB dhe XA.



### Kristi Mihilli

Ka mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe studimet master në vitin 2018 dhe është i apasionuar ndaj fizikës dhe matematikës.

Kristi është i punësuar me kohë të pjesshme tek Shkolla NEHEMIA dhe zhvillon lëndën e informatikës për klasat IV, V, XI dhe XII.



### Marsela Myftari

Është diplomuar në vitin 2007 në degën e Marketingut, në Fakultetin Ekonomik. Për t'i shtuar akoma edhe më shumë aftësitë e saj profesionale, në vitin 2017 ka kryer studimet e larta edhe në degën Gjuhë dhe Letërsi shqipe në Fakultetin e

Filologjisë në Tiranë, ku ka përfunduar edhe masterin profesional për mësuesi në 2019-ën. Motoja e saj: "Mësimdhënia është pika e takimit midis shkronjave dhe numrave".

Marsela është e punësuar me kohë të plotë tek Shkolla NEHEMIA dhe zhvillon lëndën e gjuhës për klasat e VI-ta dhe ekonomisë për klasat e XII-ta.



### Lumturi Guri

Ka mbaruar studimet në Institutin e Lartë Pedagogjik Elbasan, dega Cikli i Ulët. Ka mbi 37 vjet përvojë në profesionin e mësueses. Pasioni dhe dëshira për mësimdhënie nuk i është shterur asnjëherë përgjatë viteve.

Lumturia është e punësuar me kohë të pjesshme si asistente për ciklin fillor, konkretisht për klasën e III-të.




### Anila Bylykbashi

Është diplomuar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë në vitin 2012 dhe ka punuar për një kohë të gjatë më fëmijët, me të cilët i pëlqen të punojë plot dëshirë dhe vullnet.

Anila është e punësuar me kohë të pjesshme si asistente për ciklin fillor, konkretisht për klasën e IV-të.

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA  
Nehemia 7304 Buçimas,  
Pogradec Albania

Tel.: +355 83 600 403  
Fax: +355 83 600 405  
shkolla-nehemia@ng.team